

# RELACION ARKITEKTONIK

ZYRË INFORMACIONI ME NJË NDALESË - BASHKIA VLORË  
(ONE STOP SHOP)



Miratohet:  
Sekretari i K.K.T.K.M-së  
Klesta QIRICI


Vlorë, Korrik 2023

## QËLLIMI I OBJEKTIT

Zyra e informacionit me një ndalesë “ONE STOP SHOP” do të ketë për qëllim mirfunksionimin e sporteve të bashkisë Vlorë duke përmirësuar ofrimin e shërbimeve, dhënien e informacionit të saktë dhe të shumëllojshëm nga qytetarët, përmirësimin e ambientit të pritjes, menaxhimin e rradhës pritëse në një zyrë të vetme.

## POZICIONI I AMBJENTIT NË STUDIM

Është menduar riorganizim i ri i zyrave me sportele me specialist nga drejtoritë përkatëse për shkak të fluksit të madh të njerëzve të cilët vijnë për të marrë informacione, për të ndarë ankesa për shërbime të ndryshme. Zyra e propozuar për ndërhyrje ndodhet në katin përdhe të Bashkisë Vlorë në krahun verior të saj, me një sipërfaqe prej 86 m<sup>2</sup>. Ambienti aktualisht është funksional dhe i pashfrytëzuar.



Planimetria e katit përdhe të gjendjes ekzistuese




Foto e gjendjes ekzistuese

## ZGJIDHJA ARKITEKTONIKE



Ambjenti ku do të ndërtohet zyra e informacionit me një ndalesë (One Stop Shop) ndodhet në katin përdhe në krahun verior të Bashkisë Vlorë dhe do të aksesohet nga jashtë me 4-shkallë dhe pandus për personat me aftësi të kufizuar, ndersa aksesimi për personelin do të jetë nga porta kryesore balllore e bashkisë.

Hyrja për në ONE STOP SHOP është menduar të bëhet duke ndërhyrë në fasaden veriore të saj, në prishje e një seksioni murature nën dritare pa çënuar sistemin konstruktive të objektin gjithashtu edhe duke marrë se pari miratimin nga Instituti i Trashëgimisë Kulturore për këtë ndërhyrje duke qënë se Bashkia Vlore është Monument Kulture e kategorise së I-rë. Material i portës hyrëse do të jetë po ashtu në përputhje të stilit dhe materialit të dritareve dhe dyerve aktuale të jashtme të objektit.




Korimanot montohen në shkallë ose anash shkallëvë, të fiksuara mirë që të garantohet stabiliteti dhe qëndrueshmëria e tyre.

Parapet rampe me hekur  $\varnothing h=1m$ .

Parmakët, preferohet të vendosen prej një materiali dhe forme të tillë, që prekja e tyre të jetë e lehtë dhe pa dëmtime.

Ne perfundim do te kemi lyerje me boje vaji ne siperfaqe metalike.

## Planimetria e katit përdhe pas ndryshimeve të propozuara



Zyra e informacionit me një ndalesë do të ketë 8-sportele ku secili sportel do të jetë i pajisur me kompjuter në të cilën qytetari do të marrin gjithë informacionin e nevojshëm në kohë reale. Do të bëhet zëvendësimi i tavanit me tavan dekorativë me ndriçim led i cili do të ofroj një ndriçim sa më efikasë për zyren gjithashtu zyra do të ketë edhe një numër të caktuar karrigesh për qytetarët të cilët do të jenë në pritje.




Ambjenti do të jetë i monitoruar nga kamerat e sigurisë.



Zyrat e tjera në shërbim të ONE STOP SHOP-it janë :

- Zyra e përgjegjësit të ONE STOP SHOP-it.
- Zyra e kordinatorëve të bashkëqeverisjes.
- Zyra e Drejtorit të Informacionit.
- Arkiva.



Hartoi relacionin :

*Drejtoria Urbanistikes*

Ark. Suela Abazaj

Ark. Klaudio Mehmetaj

Ark. Erisa Muka

Ark. Ingli Xhaferaj

Ing. Edmond Beqiri

Drejtör Zambak SELMANI

*Drejtoria Rajonale e Trashegimise Kulturore Vlore*

Drejtör Orgest FEIMI

Përgjegjës sektori Marsel Berdaj